



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:044089

Datë: 05.11.2024

Numri i dokumentit: 06403790

K.Dh.Sh.II.nr.1364/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Faton Bajrami, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Korporata Energjetike e Kosovës SH.A., me seli në Prishtinë, adresa, Bulevardi “Nënë Tereza” nr. 36, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fahri Fazliu, D.P.H. kundër të paditurit D.P.H. “Qajtores Dreni”, me pronarë A.R. nga Komuna e Vushtrrisë rr. “Dëshmorët e Kombit” me objekt kontesti, kthim borxhi, vlera e kontestit 2,217.50€, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë KE.nr.2593/22 të datës 24.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e të paditurës D.P.H. “Qajtores Dreni”, me pronarë A.R. nga Komuna e Vushtrrisë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë KE.nr.2593/22 të datës 24.05.2024 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Korporata Energjetike e Kosovës SH.A., dhe e ka detyruar të paditurën D.P.H. “Qajtores Dreni” që në emër të borxhit, t’ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 1,072.08€ (një mijë e shtatëdhjetë e dy euro e tetë cent) me kamatë ligjore si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destnim të caktuar, nga dita e paraqitjes së propozimit me datë 27.11.2012 e deri në përmbushjen definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi. Me pikën II të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit Korporata Energjetike e Kosovës SH.A., përtej shumës së gjykuar në dispozitivin I të këtij Aktgjykimi dhe atë në lartësinë prej 1,145.42€ (një mijë e njëqind e dyzet e pesë euro e dyzet e dy cent). Ndërkaq në pikën III të dispozitivit është vendosur që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të

drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ashtu që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

- Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Korporata Energjetike e Kosovës SH.A., pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri ka paraqitur fillimisht propozim për përmbarrim ndaj debitorit D.P.H. “Qajto Dreni”, e cila më vonë është trajtuar si padi për kthim të borxhit, përmes të cilës paditësi ka kërkuar kthimin e borxhit në lartësi prej 2,217.50€ në emër të shpenzimeve të furnizimit me energji elektrike.

Gjykata e shkallës së parë në arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar, ka ardhur konstatuar se nuk ishte kontestuese se në mes palëve ndërgjygjëse ekzistonte një raport kontraktual, ku paditësi kishte cilësinë e shitësit të shërbimeve të furnizimit me energji elektrike, ndërkaq i padituri ishte konsumator, respektivisht pranues i shërbimit të furnizimit me energji elektrike. Nga provat e administruara gjykata e shkallës së parë erdhi në përfundim se nga Fatura nr. 4444481 e datës 03.11.2012, borxhi i të paditurit i paraqitur në këtë faturë nga paditësi ishte paraqitur në lartësi prej 2,217.50€, ndërsa nga transaksionet e konsumatorit nr. 9012471 për periudhën 01.02.2007 deri 24.11.2014 gjykata konstatoi se i padituri gjatë periudhës 01.07.2007 deri me datën 30.10.2012 për të cilën paditësi kërkon kthimin e borxhit paditësi, kishte bërë disa pagesa brenda muajve dhe viteve të kësaj periudhe, dhe se borxhi i mbetur bashkë me atë të bartur rezulton 2,217.50€. Pas administrimit të provave gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe atë për faktin se i padituri nga raporti juridik me paditësin, i cili i kishte ofruar shërbimin e furnizimit me energji elektrike, gjatë periudhës 01.07.2007 deri me datën 30.10.2012 i kishte mbetur borxh paditësit shumë në lartësi prej 1,072.08€. Deri te ky vlerësim gjykata e shkallës së parë erdhi duke u bazuar në ekspertizën financiare e cila konstaton se paditësi nga data 01.07.2007 e gjerë me datën 30.10.2012 ka pasur obligim pagesën e borxhit në lartësi prej 1,072.08€, ndërkaq pjesa në lartësi prej 1,145.42€ ka qenë borxh i bartur para vitit 2007. Andaj, gjykata e shkallës së parë bazuar në provat e administruara gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar sa i përket shumës në lartësi prej 1,072.08€, pasi që gjykata edhe në bazë të provave të tjera, respektivisht transaksionet e konsumatorit nr. 9012471 për periudhën 01.02.2007 deri 24.11.2014 vërtetoi se i padituri kishte borxh ndaj paditësit shumë e lartëkur. Gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit përtej shumës së gjykuar në dispozitivin I, pasi që nga provat e administruara gjykata nuk gjeti se i padituri i ka borxh paditësit shumë e pretenduar, për shkak që nga ekspertiza financiare të cilës gjykata ia fali besimin, u vërtetua se borxhi në lartësi prej 1,145.42€ ka qenë borxh i bartur para vitit 2007.

Gjykata Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm lidhur me të gjitha pikat e dispozitivit të aktgjykimin, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të

procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhomat e shkallës së dytë gjejnë se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për vendosjen përkritazi me faktet vendimtare. Sipas vlerësimit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses për shkak të borxhit. Kolegji i kësaj gjykate i ka vërtetuar qëndrimet e gjykatës së shkallës së parë se në rastin konkret nuk ishte kontestues fakti i ofrimit, respektivisht pranimit të shërbimeve komunale të energjisë nga e paditura. Sa i takon lartësisë së borxhit e njëjta në mënyrë të drejtë është konstatuar bazuar në shkresat e lëndës ashtu që gjykata e shkallës së parë mbi bazën e provave të mjaftueshme ka vërtetuar faktin e lartësisë së borxhit. Se i padituri nga raporti juridik me paditësin, i cili i kishte ofruar shërbimin e furnizimit me energji elektrike, gjatë periudhës 01.07.2007 deri me datën 30.10.2012 i kishte mbetur borxh paditësit shumë në lartësi prej 1,072.08€, është vërtetuar nga provat materiale të administruara në procedurë e të cilat nuk janë kontestuar në vlefshmërinë e tyre. Mbi këtë gjendje të çështjes, gjykata e shkallës së parë ia fali besimin ekspertizës financiare e cila konstaton se paditësi nga data 01.07.2007 e gjerë me datën 30.10.2012 ka pasur obligim pagesën e borxhit në lartësi prej 1,072.08€, ndërkaq pjesa në lartësi prej 1,145.42€ ka qenë borxh i bartur para vitit 2007.

Sa i përket vlerësimit të parashkrimit të kërkesës, qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe faktet e vërtetuara në procedurën para kësaj gjykate, e përkrahë edhe kolegji i kësaj gjykate për faktin se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se shuma në lartësi prej 1,072.08€, bazuar në transaksionet e konsumatorit nr. 9012471 për periudhën 01.02.2007 deri 24.11.2014 nuk është parashkruar pasi që në këtë rast kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit pasi që i padituri në vazhdimësi ka realizuar pagesa të shpenzimeve të energjisë elektrike dhe atë gjatë viti 2012 ka bërë pagesë me datë 14.03.2012, 17.04.2012, 11.06.2012, gjatë vitit 2011 ka bërë pagesë me datë 14.02.2011, 15.03.2011, 27.06.2011, 21.10.2011, gjatë vitit 2010 ka bërë pagesë me datë 25.01.2010, 10.02.2010, 23.03.2010, 30.04.2010, 18.05.2010, 24.05.2010, 15.06.2010, 17.07.2010, 23.07.2010. Në këtë gjendje të fakteve Kolegji vlerëson se në kuptim të nenit 387 të LMD-së, nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës pasi që me Nenin 387 të LMD është paraparë se: *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori pohon borxhin. Pohimi i borxhit mund të blihet jo vetëm duke i dhënë deklaratë kreditorit por edhe në mënyrë indirekte, siç janë dhënia e kisteve, pagimi i kamatave, dhënia e sigurimit.”*

Kolegji vlerëson se në rastin konkret i padituri ka kryer pagesa të kohë pas kohëshme për të cilat është ndërprerë parashkrimi në kuptim të Nenit 387 të LMD. Pretendimet e të paditurit referuar qëndrimin të Gjykatës Supreme të Kosovës se kemi të bëjmë me pagesa periodike, e paditura i referon në një gjendje faktike e cila nuk përputhet me rrethanat e rastit konkret. Në këtë çështje juridike gjykata nuk ka administruar asnjë faturë. Përmes ekspertizës financiare është konstatuar se faturat janë paguar për pagesa specifike. Qëndron fakti se pagesat e energjisë janë pagesa

periodike, mirëpo me faktin se e paditura ka bërë pagesa periodike është pohuar borxhi në kuptim të Nenit 387 dhe muajt paraparak të papaguar nuk nënkupton të jenë parashkruar. Rrjedhimisht, Kolegji vlerëson se është i drejtë qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë në raport me parashkrimin e kërkesave vetëm për periudhën e bartur para vitit 2007.

Së këndejmi, Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar edhe të drejtën materiale kur ka konstatuar bazën juridike të kërkesëpadisë dhe mënyrën e trajtimit të parashkrimit

Dhomat e Shkallës së Dytë i vlerësuan edhe pretendimet tjera ankimore të paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë përmes ekspertizave profesionale të mjaftueshme, e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse në arsyetimin e aktgjykimit, të cilën e pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1364/24, me datë 24.10.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova